



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 10 prill 2018

Numri i lëndës: 2016-34

R.I.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 10 prill 2018, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Z. Anna Bednarek, anëtar zëvendësues

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panel më 8 nëntor 2016.
2. Paneli ka miratuar kërkesën e parashtruesit të ankesës që emri i tij mos të zbulohet. Ai do të përmenden si R.I.

II. FAKTET

3. Faktet e paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:

4. Ankuesi pohon se është pronar i një ngastre toke, e cila ai thotë se është uzurpuar në mënyrë të paligjshme nga M.M. që nga viti 1998.
5. Më 31 korrik 2013, ankuesi ka parashtruar një ankesë kundër M.M. në Gjykatën Themelore në Ferizaj, duke kërkuar që i pandehuri të lirojë dhe t'ia kthejë pronën.
6. Në aktgjykimin e datës 15 korrik 2014, Gjykata Themelore e Ferizajt, ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit dhe ka konfirmuar se i pandehuri ishte pronar i pronës së kontestuar. Po ashtu ka kërkuar nga ankuesi që t'i lejojë M.M. të regjistroj pronën në emër të tij në kadastër.
7. Më 3 shtator 2014, ankuesi është ankuar ndaj këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit.
8. Duket se procedurat ende janë të pazgjidhura në gjykatën e shkallës së dytë.

III. ANKESAT

9. Pa u thirrur në ndonjë instrument të veçantë ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ankuesi kërkon që Paneli të ndërhyjë në procedurat që janë pranë Gjykatës së Apelit. Nga përmbajtja e ankesës së tij duket se çështja e ankimuar ka të bëjë me të drejtën e ankuesit në pronë, siç garantohet, ndër të tjera, me nenin 1 të Protokollit 1 të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. LIGJI

10. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
11. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29, në lidhje me rregullën 25 të rregullores së punës.
12. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat në lidhje me shkëljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.

13. Paneli thekson që ankesa e ankuesit ka të bëjnë me procedurat civile pranë Gjykatës Themelore të Ferizajt. Sipas rregullës 25, paragrafit 1, bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it Kosovë, Paneli në parim nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Si pasojë, Paneli nuk mund të ndikoj në rezultatin e procedurave gjyqësore apo shpejtësinë me të cilat ankesat në pritje shqyrtohen nga gjykatat e Kosovës. Edhe kur gjykatësit e EULEX-it marrin pjesë në procedurat që zhvillohen pranë gjykatave të Kosovës, sikurse në këtë lëndë, ky fakt nuk ia humb asaj gjykate karakterin e të qenurit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih në mes të autoriteteve të tjera, *Z.A. kundër EULEX-it*, 2014-36, 29 shkurt 2016, paragrafi 17; *K.P. kundër EULEX-it*, 2014-31, 21 prill 2015, paragrafi 13; *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2013-15, 4 shkurt 2014, paragrafi 13). Paneli gjithashtu konstaton se ankuesi nuk përmend asnjë lloj përfshirjeje tjetër të EULEX-it në këtë rast.
14. Paneli në bazë të argumenteve të parashtruara nga ankuesi nuk është i bindur se çështja e ankimuar mund t'i atribuohet Misionit, në mandatin e tij ekzekutiv.
15. Prandaj kjo ankesë bie jashtë mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë që ta shqyrtoj këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese